

ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA

Rezultatet nga
gjurmimi i të
diplomuarve
2016-2022



Ky raport është hartuar nga Jonida Jani nën kujdesin e Aleka Papa, Projekti “Aftësi për Punë” (S4J).

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2022)	7
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2022)	7
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2022)	7
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)	8
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2022)	9
Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2016-2022)	9
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2022)	10
Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2022)	10
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2022)	11
Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2020-2022)	11
Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2022)	12
Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022	14
Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2016-2022	14
Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2022)	15
Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2022)	15
Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt me kohë të pjesshme (2016-2022)	16
Figura 17: Madhësia e kompanisë (2016-2022)	16
Figura 18: Lloji i kontratës (2016-2022)	17
Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2022)	17
Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022)	19
Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)	21
Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)	21
Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2022)	22
Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2022)	22
Figura 25: Papunësia ndër vite	23
Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2021)	24
Figura 27: Metodatat e kërkimit për punë (2020-2022)	25
Figura 28: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2016-2022)	26
Figura 29 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022)	27
Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi (2018-2022)	28
Figura 31: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë (2018-2022)	28

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit	6
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2022)	12
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2022)	13
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2022)	13
Tabela 5: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2022)	18
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2022)	19
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së pare (2016-2022)	20
Tabela 8: Ndhima e shkollës në gjetjen e punës së pare (2016-2022)	20
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)	23
Tabela 10: Arsyet kryesore pas papunësisë (2016-2022)	24
Tabela 11: Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë (2020-2022)	25
Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2016-2022)	26
Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2022)	27
Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2022)	29

Tabela e përmbajtjes


1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?	5
2. Të diplomuarit 2016-2022	6
3. Analiza e rezultateve.....	8
3.1 Statusi i punësimit.....	8
3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit	10
3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës	12
3.4 Niveli i pagave.....	13
3.5 Kushtet e punës	15
3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës.....	18
3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë.....	18
3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë.....	19
3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme	20
3.10 Të diplomuarit pa punë.....	23
3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë	26
3.12 Planet për të ardhmen	28
4 Përfundime	29

1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të diplomuarit pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.


Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, **Shkolla Industriale Pavarësia**, me mbështetjen e projektit ‘Aftësi për Punë’ (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

- Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
- Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësi të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësi të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmblylëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njesisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit 'Aftësi për punë'.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **shtatë brezave me të diplomuar** të Shkollës Industriale Pavarësia.

2. Të diplomuarit 2016-2022


Në vitin shkollor 2021-2022, në Shkollën Industriale Pavarësia u diplomuan 125 nxënës (shiko tabelën 1), 24 nxënës më pak sesa gjatë vitit 2020-2021, vit në të cilin shkolla pati numrin më të lartë të të diplomuarve, me një total prej 149 nxënësish.

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2015-2016	73	20	27%
2016-2017	98	59	60%
2017-2018	126	61	48%
2018-2019	95	55	58%
2019-2020	124	103	83%
2020-2021	149	121	81%
2021-2022	125	101	81%

Nga të diplomuarit e vitit 2021-2022 u gjurmuan 101 nxënës ose 81% e të diplomuarve. Pjesa më e madhe e të diplomuarve të gjurmuar i përkasin gjinisë mashkullore 94% (N=95) dhe vetëm 6% (N=6) gjinisë femërore (shiko figurën 1).


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=101

Ndërsa të shpërndarë sipas drejtimeve (shiko figurën 2), përqindjen më të lartë të të gjurmuarve e kanë të diplomuarit e drejtimit TIK me 37% dhe më të voglin ata të drejtimit Termohidraulik me 13%.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=101

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 89% (N=90) e të diplomuarve janë përgjigjur se jetojnë në Shqipëri, krahasuar me 95% (N=98) të të diplomuarve në vitin 2020. Sikurse vërehet nga figura 3, numri i të diplomuarve që jetojnë jashtë vendit ka pësuar një rritje nga viti 2020 me vetëm 5% (N=5) të të diplomuarve në 11% (N=11) në vitin 2022. Megjithatë, vihet re një ulje me tre pikë përqindje krahasuar me vitin 2021 (14%, N=17).

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=103); 2021 (N=121); 2022 (N=101)


Nga të diplomuarit që jetojnë jashtë vendit, 3 (tre) jetojnë në Angli dhe 3 (tre) në Itali. Ndërkohë, në Gjermani, Kanada dhe Spanjë jeton përkatësisht nga 1 (një) i diplomuar në secilin shtet.

3. Analiza e rezultateve

3.1 Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2021-2022), nga një total prej 101 të anketuarish 56% ishin të punësuar një vit pas diplomimit (shiko figurë 3), 8% ishin të vetëpunësuar, 16% ishin të punësuar por edhe studiojnë në të njëjtën kohë, 7%, ishin student/kursant. Ndërkohë, të papunë ishin 11% e të anketuarve.


Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=101

Referuar figurës 5, viti 2022 shënon vlerat më të larta të punësimit të të shtatë brezave të gjurmuar. Megjithatë, duhet përmendur fakti që gjatë këtij viti kemi një ulje të numrit të të diplomuarve (referohu tabelës 1), në krahasim me vitin 2021. Në këtë kontekst mund të konkludojmë që dy vitet e fundit, përkatësisht 2020-2021 dhe 2021-2022 janë vitet që shënojnë vlerat më të larta të punësimit. Ndërkohë, përqindja e atyre që vijojnë studimet e mëtejshme mbetet konstante, ndërsa papunësia ka ardhur duke u ulur vit pas viti. Nga të diplomuarit e vitit 2022, 11% e tyre janë të papunë.


Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=20); 2017 (N=58); 2018: (N=61); 2019: (N=55); 2020: (N=103); 2021: (N=121); 2022: (N=101)

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetë-punësuar. Sikurse vihet re nga figura 6, shumica e të diplomuarve ndër vite janë shprehur se janë të punësuar dhe një numër i vogël prej tyre janë të vetë-punësuar. E shprehur në numër absolut mesatarisht 6 (gjashtë) të diplomuar vetë-punësohen në vit.

Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2016-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=20); 2017 (N=58); 2018 (N=61); 2019 (N=55); 2020: (N=103); 2021: (N=121); 2022: (N=101)

Në figurën 7, jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve të ofruara nga shkolla. Sikurse vihet re, drejtimi me numrin më të lartë të të punësuarve për vitin 2021-2022, është Termohidraulika me 100% (N=13) të punësuar. Ndërkohë drejtimi i cili ka numrin më të lartë të të papunëve është TIK me 19% (N=7). Po i njëjti drejtim ka edhe numrin më të lartë të të diplomuarve që ndjekin studime

të mëtejshme 19% (N=7). Ndërkohë, Elektroteknika dhe Mekanika kanë përkatësisht nga 94% të diplomuarve të punësuar dhe 6% të papunë.


Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumica e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** EL (N=17); TH (N=13); M (N=16); SHMT (N=18); TIK (N=37).

Të ndara sipas gjinisë (shih figurën 8), të dhënat tregojnë se 82% (N=78) e të diplomuarve meshkuj janë të punësuar, 10% (N=9) janë të papunë dhe 6% (N=6) janë student ose kursant. Ndërkohë, 50% (N=3) e të diplomuarve të gjinisë femërore janë të punësuar, 33% (N=2) janë papunë dhe 17% (N=1) janë studente ose kursante.

Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumica e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=95); F (N=6).

3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 54% e të diplomuarve u përgjigjën pozitivisht. Ndër vite (shiko figurën 9), më shumë se gjysma e të diplomuarve pohojnë se puna lidhet me fushën e tyre të studimit. Përrjashtim bën viti 2019, ku vetëm 48% e të diplomuarve pohojnë se puna lidhet me fushën e tyre të arsimit.

Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=9); 2017 (N=37); 2018 (N=36); 2019 (N=33); 2020 (N=74); 2021 (N=92); 2022 (N=81)

Nëse analizojmë lidhjen e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (shiko figurën 10), vërehet se mesatarisht 80% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 67% e të diplomuarve në Mekanikë, 60% e të diplomuarve në SHMT dhe 54% e të diplomuarve në profilin Elektroteknikë pohojnë se punojnë në profesionin e tyre. Ndërkohë, mesatarisht 27% e të diplomuarve në drejtimin TIK pohojnë se punojnë në profesionin e tyre.

Megjithatë, sikurse vihet re nga figura, kemi një rënie me 22 pikë përqindje të punësimit në profesion për të diplomuarit në drejtimin Termohidraulikës nga viti 2020 në vitin 2022. Ulje e përqindjes së të punësuarve në profesion vihet re edhe për të diplomuarit në Mekanikë me 26 pikë përqindje nga viti 2021 në 2022, dhe me 4 pikë përqindje për të diplomuarit në TIK për të njëjtën periudhë. Ndërkohë, një rritje me 4 pikë përqindje vërehet për të diplomuarit në Elektroteknike nga viti 2021 në vitin 2022, dhe me 16 pikë përqindje për të diplomuarit në drejtimin SHMT.


Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2020:** N_{TIK}=15, N_{SHMT}=26, N_M=13, N_{TH}=11, N_{EL}=9; **Baza 2021:** N_{TIK}=25, N_{SHMT}=21, N_M=33, N_{TH}=5, N_{EL}=8; **Baza 2022:** N_{TIK}=22, N_{SHMT}=15, N_M=15, N_{TH}=13, N_{EL}=16

Të ndara sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se 55% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 33% e gjinisë femërore punojnë në profesion.

Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=78); F (N=3)

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), vërehet se të diplomuarit e brezit 2021-2022 japin dy arsye kryesore: (i) pamundësia për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet (50% në 2022, mesatarja (2018-2021) 47%), si dhe (ii) paga/kushtet më të mira të punës aktuale (35% në 2022, mesatarja (2018-2021) 21%). Ndërkohë, mungesa e ofertës rajonale të punës të lidhur me arsimimin, nuk përbën më një arsye të qënësishme të mospërputhjes së punës. (6% në 2022, mesatarja (2018-2021) 14%).

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	43%	80%	31%	35%	50%
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	21%	10%	0%	3%	6%
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	7%	0%	34%	16%	6%
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	7%	0%	34%	42%	35%
Tjetër	21%	10%	0%	3%	3%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=14); 2019 (N=10); 2020 (N=29); 2021 (N=31); 2022 (N=34)

3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në 2022 tregojnë se njohuritë përdoren “shumë/jashtëzakonisht shumë” nga 39% e të gjurmuarve. Vihet re një rënie me 22 pikë përqindje në krahasim me vitin e mëparshëm.

Ndërkohë, 23% e të diplomuarve janë përgjigjur se i përdorin “aspak” njohuritë e fituara gjatë studimeve. Mesatarja për këtë kategori për vitet 2016-2021 ka qenë 33%. Pra, kemi ndër vite një ulje me 10 pikë përqindje të numrit të të diplomuarve të cilët pohojnë se nuk i përdorin “aspak” njohuritë e fituara në shkollë në vendin e punës. Ndërsa kategoria e atyre që janë përgjigjur se i përdorin “disi”, mesatarish nuk ka pësuar ndryshime. Kështu, për vitin 2022, 17% e të gjurmuarve pohojnë se i përdorin “disi” njohuritë, ndërkohë që mesatarja e viteve 2016-2021 për këtë kategori është 18%.

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2022)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2016	33%	11%	22%	0%	33%
Të diplomuar në 2017	44%	2%	12%	9%	33%
Të diplomuar në 2018	28%	17%	14%	25%	17%
Të diplomuar në 2019	37%	13%	13%	16%	21%
Të diplomuar në 2020	42%	8%	30%	15%	5%
Të diplomuar në 2021	11%	10%	18%	20%	41%
Të diplomuar në 2022	23%	21%	17%	14%	25%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=9); 2017 (N=43); 2018 (N=36) 2019 (N=38); 2020 (N=74), 2021 (N=92); 2022 (N=81)

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 36% e të diplomuarve në vitin 2022 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Nga ana tjetër, 45% e vlerësojnë me “pak/aspak” lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimit.

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2022)


	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2016	33%	11%	11%	33%	11%
Të diplomuar në 2017	44%	12%	7%	5%	33%
Të diplomuar në 2018	33%	14%	17%	11%	25%
Të diplomuar në 2019	39%	8%	18%	18%	16%
Të diplomuar në 2020	42%	7%	30%	18%	4%
Të diplomuar në 2021	15%	3%	21%	37%	24%
Të diplomuar në 2022	20%	25%	20%	16%	20%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=9); 2017 (N=43); 2018 (N=36) 2019 (N=38); 2020 (N=74), 2021 (N=92); 2022 (N=81)

3.4 Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2022 (shiko figurën 12), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 11% më pak se paga minimale, 21% paga minimale-35,000 lekë, 32% në fashën 35,001-50,000 lekë, 10% në fashën 50,001-65,000 lekë, 10% në fashën 65,001-80,000 lekë dhe 16% paguhen më shumë se 80,001 lekë.


Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=81

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko figurën 13), pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve. Përqindja e të gjurmuarve që kanë pagë më të ulët se 35.000 lekë është ulur me 34 pikë përqindje nga brezi i parë i gjurmuar 2015-2016 (66% në 2016, 32% në 2022). Ndërkohë është rritur me 9 pikë përqindje niveli i të diplomuarve që kanë një pagë 50,001-80,001 lekë (11% në 2016, 20% në 2022). 16% e të diplomuarve në 2022 marrin më shumë se 80,000 lekë.


Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2016-2022



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=9); 2017 (N=43); 2018 (N=36) 2019 (N=38); 2020 (N=74), 2021 (N=92); 2022 (N=81)

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 14), vëmë re se 23% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 20% e të diplomuarve në SHMT, 19% e të diplomuar në Elektroteknike dhe 18% e të diplomuarve në TIK, paguhen më shumë se 80,001 lekë në muaj. Ndërkohë, në fashën e pagave 50,001-80,000 lekë, paguhen përkatësisht 25% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 8% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 40% e të diplomuarve në Mekanikë, 20% e të diplomuarve në SHMT dhe 9% e të diplomuarve në TIK.


Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimeve (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N_{EL}=16, N_{TH}=13, N_M=15, N_{SHMT}=15, N_{TIK}=22.

Nga të dhënat të disagreguara sipas gjinisë (figura 15), shohim se edhe pse numri i vajzave të gjurmara në 2022 është shumë i vogël (3 vajza të punësuara) ato nuk marrin një pagë më të lartë se 35,000 lekë. Ndërkohë, 20% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore paguhen 50,001-80,000 lekë, dhe 17% më shumë se 80,001 lekë.

Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=78); F (N=3).

3.5 Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), për të shtatë brezat e gjurmuar vërehet një punësim mbi mesataren me kohë të plotë. Përqindjen më të ulët e kanë pasur të diplomuarit e vitit 2020 me 60%. Në të njëjtin vit (2020), vërehet një rritje e numrit të atyre

që punojnë me kohë të plotë, sezonale. Ndërkohë, për vitin 2022, 78% e të diplomuarve shprehen se punojnë me kohë të plotë dhe 10% me kohë të plotë sezonale.


Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë me kohë të pjesshme (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=8); 2017 (N=32); 2018 (N=32) 2019 (N=24); 2020 (N=63), 2021 (N=85); 2022 (N=73)

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 17), në brezin e fundit të të gjurmuarve vërehet se 72% e të diplomuarve punojnë në kompani me 1-9 punonjës, 21% në kompani me 10-49 punonjës, dhe 7% në kompani me mbi 50 punonjës. Numri i të diplomuarve që punojnë në kompani me mbi 50 punonjës vazhdon të mbetet i ulët (mesatarisht 9%).

Figura 17: Madhësia e kompanisë (2016-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=8); 2017 (N=32); 2018 (N=32) 2019 (N=24); 2020 (N=63), 2021 (N=85); 2022 (N=73)

Në vitin 2022, 61% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 18). Nga ku, 42% kanë një kontratë pune me afat të pacaktuar dhe 19% me afat të caktuar. Ndërkohë, 29% nuk kanë një kontratë. Ndonëse numri i këtyre të fundit mbetet i lartë, vërehet një përmirësim i situatës nga viti në vit. Kështu, në vitin 2017, 50% e të diplomuarve nuk kishin një kontratë pune me

punëdhënësin e tyre. Situata u përmirësua ndjeshëm dhe viti 2021 shënon vlerën më të ulët të të diplomuarve të cilët nuk kanë një kontratë me punëdhënësin e tyre, me vetëm 19%.


Figura 18: Lloji i kontratës (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=8); 2017 (N=32); 2018 (N=32); 2019 (N=24); 2020 (N=63); 2021 (N=85); 2022 (N=73)

Sipas rezultateve të gjurmimit të të shtatë brezave, 75% e të diplomuarve të punësuar deklarojnë se u paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 19). Kjo mesatare është ulur sidomos nga të dhënat e gjurmimit të të diplomuarve në vitin 2020 ku vetëm 54% e të diplomuarve deklaruan se u paguheshin kontributet nga punëdhënësi. Në vitin 2021 kemi një rritje prej 35 pikë përqindje duke çuar nivelin e të diplomuarve të cilëve u paguhen kontributet në 89%, por numri është ulur sërish në 2022 me 19 pikë përqindje duke e çuar nivelin e të diplomuarve të cilëve u paguhen kontributet në 70%. Ndërkohë, në vitin 2022 është rritur sërish (14%) numri atyre të cilët nuk kanë informacion nëse u paguhen apo jo kontributet (2% në 2021).

Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=8); 2017 (N=32); 2018 (N=32); 2019 (N=24); 2020 (N=63); 2021 (N=85); 2022 (N=73)

3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 68% e të diplomuarve në vitin 2022, u shprehën se ndjehen “të sigurt ose shumë të sigurt” (shiko tabelën 5). Ndërkohë të diplomuarit që janë shprehur “shumë të pasigurt” janë vetëm 8%. Vërehet se nga të diplomuarit e gjurmuar në vitin 2020, vetëm 3% ndiheshin “shumë të sigurt” dhe vetëm 5% “shumë të kënaqur”. Situata u përmirësua për të dyja kategoritë në vitin 2021, përkatësisht 15% janë shprehur “shumë të sigurt” dhe 14% “shumë të kënaqur”. Përmirësimi vijoi edhe gjatë vitit 2022, me 34% “shumë të sigurt” dhe 34% “shumë të kënaqur”

Ndërkohë, të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 72% e të diplomuarve në vitin 2022 shprehen se ndjehen “të kënaqur ose shumë të kënaqur” dhe vetëm 3% shprehen “shumë të pakënaqur”. Sikurse e tregon edhe tabela 5, vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.

Tabela 5: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2022)


	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Shumë i/e pasigurt	0	0	1 (3%)	2 (8%)	0	3 (4%)	6 (8%)
I/e pasigurt	2 (25%)	7 (22%)	4 (12%)	4(17%)	16 (25%)	7 (8%)	5 (7%)
Neutral	0	6 (19%)	9 (28%)	1 (4%)	23 (37%)	16 (19%)	12 (16%)
I/e sigurt	3 (37.5%)	9 (28%)	13 (41%)	11 (46%)	22 (35%)	46 (54%)	25 (34%)
Shumë i/e sigurt	3 (37.5%)	10 (31%)	5 (16%)	6 (25%)	2 (3%)	13 (15%)	25 (34%)
Shumë i/e pakënaqur	1 (11%)	2 (5%)	3 (8%)	2 (6%)	2 (3%)	1 (1%)	2 (3%)
I/e pakënaqur	1 (11%)	6 (16%)	4 (11%)	2 (6%)	10 (14%)	10 (12%)	2 (3%)
Neutral	0 ()	8 (22%)	8 (23%)	3 (9%)	20 (27%)	18 (21%)	16 (22%)
I/e kënaqur	3 (34%)	9 (24%)	17 (47%)	18 (55%)	38 (51%)	44 (52%)	28 (38%)
Shumë i/e kënaqur	4 (44%)	12 (33%)	4 (11%)	8 (24%)	4 (5%)	12 (14%)	25 (34%)

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=8); 2017 (N=32); 2018 (N=32) 2019 (N=24); 2020 (N=63), 2021 (N=85); 2022 (N=73)

3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 70% e të diplomuarve në vitin 2022 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punën para diplomimit. Në vitin 2021 (shiko tabelën 6) vetëm 52% e të diplomuarve u përgjigjën se kishin arritur të gjenin punë para se të përfundonin shkollën.

Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=77

Ndërkohë, 10% e të diplomuarve arrijnë të gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit, aq sa është edhe mesatarja e viteve 2016-2021 (shiko tabelën 6). Pra, për këtë kategori nuk vihen re ndryshime. Përmirësime vërehen në numrin e atyre të diplomuarve që gjejnë punë 1-3 muaj pas diplomimit (9% në 2022, përkundrejt 13% (mesatarja) në vitet 2016-2021), si dhe atyre që e gjejnë punën 3-6 muaj pas diplomimit (4% në 2022, përkundrejt 8% (mesatarja) në vitet 2016-2021). Vlen të theksohet se përqindja e atyre që gjejnë punë 1 vit pas diplomimit vijon të mbetet 0 (zero) për të gjithin vit radhazi.

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Para diplomimit	50%	66%	70%	72%	44%	52%	70%
1 muaj pas diplomimit	10%	8%	10%	7%	6%	17%	10%
1 - 3 muaj pas diplomimit	20%	8%	10%	3%	26%	12%	9%
3 - 6 muaj pas diplomimit	0%	5%	5%	14%	16%	7%	4%
6 - 9 muaj pas diplomimit	0%	11%	3%	3%	7%	7%	3%
9 - 12 muaj pas diplomimit	10%	3%	3%	0%	1%	5%	4%
Më shumë se 1 vit pas diplomimit	10%	0%	0%	0%	0%	0%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=10); 2017 (N=38); 2018 (N=40); 2019 (N=29); 2020 (N=73); 2021 (N=92); 2022 (N=77)

3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, vërehet se për të shtatë brezat e gjurmuar lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre janë forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë me një mesatare prej 68% në të shtatë brezat. Tek të diplomuarit në 2022 kjo përqindje është 66%.

Nga ana tjetër, tek të diplomuarit e dy viteve të fundit (2021-2022) shohim një rritje të numrit të të diplomuarve të cilët arrijnë të punësohen në sajë të njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale ose gazeta me një mesatare prej 17%. Për vitet 2016-2020, kjo mesatare ka qenë 3%. Si rezultat kemi një rritje me 14 pikë përqindje të gjetjes së punës përmes njoftimeve për punë. Ndërkohë, vërehet se gjetja e punës përmes praktikës profesionale në biznes ka pësuar një rënie në vitin 2022 me 10 pikë përqindje referuar vitit 2021. Gjithashtu, edhe mënyra duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin për vitin 2022 ka pësuar një rënie me 5 pikë përqindje krahasuar me 2021.

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së pare (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	0%	5%	0%	0%	11%	19%	16%
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	80%	63%	78%	72%	75%	38%	66%
Nga praktika profesionale në biznes	10%	0%	10%	17%	8%	16%	6%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	10%	16%	5%	7%	1%	11%	6%
Nga mësuesit	0%	0%	3%	0%	4%	9%	3%
Nga Zyra e Punësimit	0%	5%	3%	0%	0%	1%	
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	0%	8%	0%	0%	0%	5%	1%
Tjetër	0%	3%	3%	3%	0%	0%	1%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=10); 2017 (N=38); 2018 (N=40); 2019 (N=29); 2020 (N=73); 2021 (N=92); 2022 (N=77)

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 8), në vitin 2022, 25% pohuan se shkolla i ka mësuar se si të aplikojnë për punë (ulje me 18 pikë përqindje referuar vitit 2021) dhe 28% pohuan se i ka ndihmuar në orientimin mbi mundësitë e ndryshme për punësim (ulje me 15 pikë përqindje referuar vitit 2021).

Gjithashtu, vërehet se për vitin 2022 është rritur ndjeshëm numri i atyre që pohojnë se përgjithësisht shkolla nuk i ka ndihmuar në gjetjen e punës së paraë (35% në 2022 nga 13% në 2021). Ky vit ka prishur trendin zbirtës të numrit të nxënësve që pohonin se nuk kanë marrë ndihmë nga shkolla në gjetjen e punës së parë. Mesatarja për dy vitet pararendëse ka qenë 11%.

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së pare (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	0%	12%	6%	18%	70%	43%	25%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	44%	30%	22%	32%	50%	43%	28%
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	44%	16%	17%	18%	24%	24%	12%
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	11%	37%	50%	32%	9%	13%	35%
Tjetër	0%	5%	6%	8%	1%	2%	7%


Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=9); 2017 (N=43); 2018 (N=36); 2019 (N=38); 2020 (N=74); 2021 (N=92); 2022 (N=81)

3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Përqindja e të diplomuarve të cilët vazhdojnë kualifikime të mëtejshme ka ardhur në rritje (shiko figurën 21). Këtu ka ndikuar rritja e përqindjes së të diplomuarve që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë. Në vitin 2021, niveli i të diplomuarve që vetëm studiojnë është i njëjtë me ato që studiojnë dhe punojnë (12%). Ndërkohë, në vitin 2022 numri i studentëve që punojnë dhe studiojnë

në të njëjtën kohë është rritur me 4 pikë përqindje duke shkuar në 16%. Njëkohësisht, është ulur dhe numri i atyre që vetëm studiojnë me 5 pikë përqindje duhe shkuar në 7%.


Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=20); 2017 (N=58); 2018 (N=61); 2019 (N=55); 2020 (N=103); 2021 (N=121); 2022 (N=101)

Sikurse në vitet paraardhëse, pjesa më e madhe e të diplomuarve në 2022 që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin (96%, 22 nga 23 të gjurmuar) dhe vetëm 4%, studiojnë pranë një shkolle profesionale pas të mesmes. Ndërkohë, asnjë i diplomuar në 2022 nuk ndjek një kurs profesional.


Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=3); 2017 (N=5); 2018 (N=7); 2019 (N=15); 2020 (N=18); 2021 (N=28); 2022 (N=23)

Nga të diplomuarit që ndjekin studime të mëtejshme, 96% (22 nga 23 të gjurmuar) studiojnë në institucione publike dhe 1 (4%) në ato private.


Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=18); 2021 (N=28); 2022 (N=23)

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet/trajnimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 24), 57% (13 nga 23) e të gjurmuarve që studiojnë janë shprehur se fusha e studimeve që po ndjekin tani lidhet me shkollën që kanë bërë, përkundrajt 43% (10 nga 23) të cilët shprehen se studimet e mëtejshme nuk lidhen me shkollën që kanë bërë. Nga viti 2020 deri në 2022 mesatarisht 68% e të gjurmuarve u shprehën se studimet/trajnimet që ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë, përkundrajt 32% të cilët pohojnë se nuk lidhen.

Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=18); 2021 (N=28); 2022 (N=23)

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), 48% e të diplomuarve në 2022 janë përgjigjur për të fituar një kualifikim më të lartë (29% mesatarja e vitetve 2016-2021), 35% për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë (52% mesatarja e vitetve 2016-2021), dhe 9% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale (19% mesatarja e vitetve 2016-2021).

Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)


	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Për të fituar një kualifikim më të lartë	0%	60%	29%	11%	44%	32%	48%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	67%	40%	57%	56%	39%	50%	35%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	33%	0%	14%	33%	17%	18%	9%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=3); 2017 (N=5); 2018 (N=7); 2019 (N=15); 2020 (N=18); 2021 (N=28); 2022 (N=23)

3.10 Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit ka rënë dy vitet e fundit në nivelin 11%. Mesatarja nga viti 2016-2020 ka qenë 25%.


Figura 25: Papunësia ndër vite



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=20), **Baza:** 2017 (N=58), 2018 (N=61); 2019 (N=55); **Baza:** 2020 (N=103); 2021 (N=121); 2022 (N=101)

Të pyetur nëse po kërkonin punë, 8 nga 11 të diplomuarit e papunë të vitit 2022 u përgjigjën që po. E shprehur në përqindje 73% e të diplomuarve të papunë janë në kërkim të një pune. Një vit më parë 6 nga 13 të diplomuar të papunë janë shprehur se ishin në kërkim të një pune.

Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2021)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=19); 2021 (N=13); 2022 (N=11)

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko tabelën 10), nxjerr në pah se arsyet më madhore që mendohet se sjellin pamundësinë për të gjetur një punë janë: pamundësia për një vend pune në qarqet ku banojnë (22% ndër vite, 38% në 2022), mospërputhja e ofertës për punë me drejtimin e të diplomuarve (13% ndër vite dhe po 13% në 2022) dhe mungesa e eksperiencës në punë (11% ndër vite, 13% në 2022). Ndërkohën, në vitet e mëparshme mungesa e kontakteve të duhura për punë është konsideruar një ndër arsyet e papunësisë me një mesatare 24% ndër vite, por për vitin 2022, nuk konsiderohet më si e tillë (0%).


Tabela 10: Arsyet kryesore pas papunësisë (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Më mungon eksperiencia e punës	0%	6%	12%	17%	12%	17%	13%
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	0%	6%	0%	0%	6%	17%	0%
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	0%	19%	24%	0%	18%	17%	13%
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	67%	6%	0%	0%	35%	33%	0%
Nuk ka punë në qarkun tim	17%	25%	18%	25%	29%	17%	38%
Jam i/e angazhuar në punë familjare	0%	6%	6%	0%	0%	0%	0%
Nga situata e krijuar nga pandemia e COVID-	0%	0%	0%	42%	0%	0%	0%
Nuk kam burime të mjaftueshme për t'u vetë-punësuar	0%	0%	41%	0%	0%	0%	0%
Tjetër	17%	31%	0%	17%	0%	0%	12.5%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=6), **Baza:** 2017 (N=16), **Baza:** 2018 (N=17); **Baza:** 2019 (N=12); **Baza:** 2020 (N=17); **Baza:** 2021 (N=6); **Baza:** 2022 (N=8)

Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend pune (shiko figurën 27), 63% e të diplomuarve në 2022 janë përgjigjur nëpërmjet njohjeve ose lidhjeve familjare, dhe po aq nëpërmjet njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale, gazeta, etj. Vëreni, se të gjurmuarit mund të zgjedhin më shumë se një alternativë për këtë pyetje. Ndërkohë, kontakti i drejtëpërdrejtë me bizneset shikohet si një tjetër mundësi për kërkimin e punës (13%).

Figura 27: Metodatat e kërkimit për punë (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=17); 2021 (N=6); 2022 (N=8)

Të pyetur për arsyet e mos kërkimit për punë (shiko tabelën 11), 2 nga 3 të diplomuarit e papunë të 1gjurmuar u përgjigjën që nuk kanë dëshirë të punojnë për momentin, dhe 1 nga 3 u përgjigj se po prishte të fillonte punë së shpejti. Këtë vit, ndryshe nga dy vitet e mëparshme askush nga të diplomuarit e papunë të gjurmuar nuk është shprehur se ka në plan të largohet nga vendi. Në vitin 2021, 3 nga 7 të gjurmuarit kanë pohuar se do largoheshin nga vendi.

Tabela 11: Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë (2020-2022)

	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Po pres të filloj punë së shpejti	0	1	1
Nuk kam besim se do gjej një punë	0	1	0
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	0	2	2
Kam në plan të largohem nga vendi	1	3	0
Tjetër	1	0	0

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=2); 2021 (N=7); 2022 (N=3)

Sikurse e tregon edhe figura 27, niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune më parë është rritur nga viti 2016 deri në vitin 2021, ndërkohë në vitin 2022 ka pësuar një ulje me 18 pikë përqindje.

Figura 28: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=6); 2017 (N=16); 2018 (N=17); 2019 (N=12); 2020 (N=19); 2021 (N=13); 2022 (N=11)

3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën 12 kanë “shumë/jashtëzakonisht shumë” nevojë për përmirësim. Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2022, mbi 40% e të gjurmuarve vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Theksi këtë vit, është sërish tek nevoja për përmirësim të praktikës në biznes, 49% (me një ulje me 23 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021). Për më tepër, kërkohet të përmirësohet bashkëpunimi me bizneset (49%), aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve (48%), si dhe praktika në shkollë (48%).


Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
<i>Infrastruktura</i>	78%	9%	25%	29%	39%	60%	41%
<i>Kurrikula</i>	0%	0%	17%	26%	50%	69%	43%
<i>Tekstet dhe materialet</i>	67%	19%	22%	39%	59%	66%	42%
<i>Metodat e mësimdhënies</i>	56%	16%	25%	29%	50%	64%	47%
<i>Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve</i>	0%	0%	14%	34%	50%	62%	48%
<i>Praktika në shkollë</i>	67%	33%	44%	39%	54%	65%	48%
<i>Praktika në biznes</i>	67%	35%	42%	45%	67%	72%	49%
<i>Këshillimi i karrierës</i>	56%	30%	39%	42%	79%	67%	44%
<i>Bashkëpunimi me bizneset</i>	33%	0%	42%	50%	84%	65%	49%
<i>Bashkëpunimi me zyrat e punësimit</i>	44%	42%	25%	47%	82%	68%	46%

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=9); 2017 (N=43); 2018 (N=36); 2019 (N=38); 2020 (N=103); 2021 (N=112); 2022 (N=101)

Nëse do të kishin mundësi, 78% e të diplomuarve do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe 68% të njëjtën shkollë (shiko figurën 28). Mesatarisht, nga viti 2018-2022, 85% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtin degë, dhe 83% të njëjtën shkollë.

Figura 29 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=61); 2019 (N=55); 2020 (N=103); 2021 (N=121); 2022 (N=101)

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e të njëjtës degë dhe shkollë paraqitet në tabelën 13. Vëmë re se kohortet e viti 2019 dhe 2020 të degës së Elektroteknikës kishin pohuar në masën 100% se do të zgjidhnin të njëjtën degë dhe të njëjtën shkollë. Ndërkohë, për vitin 2022, 94% e të diplomuarve në Elektroteknikë do të zgjidhnin të njëjtën degë dhe 76% të njëjtën shkollë. Ulja e gatishmërisë për të përzgjedhur të njëjtën degë dhe shkollë u vu re që në vitin 2021 me përkatësisht me 12 dhe 24 pikë përqindje.

Në degët e tjera vërehet një ulje me disa pikë përqindje e gatishmërisë për të përzgjedhur të njëjtën degë dhe të njëjtën shkollë krahasuar me një vit më parë.


Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2022)

		Elektroteknikë	Termohidraulikë	Mekanikë	SHMT	TIK
Të diplomuar në 2018	Degë	67%	100%	67%	74%	88%
	Shkollë	60%	75%	73%	79%	63%
Të diplomuar në 2019	Degë	100%	67%	85%	85%	91%
	Shkollë	100%	89%	92%	92%	100%
Të diplomuar në 2020	Degë	100%	100%	94%	97%	97%
	Shkollë	100%	86%	89%	93%	93%
Të diplomuar në 2021	Degë	88%	100%	91%	93%	91%
	Shkollë	76%	88%	91%	86%	91%
Të diplomuar në 2022	Degë	94%	62%	81%	67%	81%
	Shkollë	76%	54%	62%	56%	78%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2018:** N_{TIK}=8, N_{SHMT}=19, N_M=15, N_{TH}=4, N_{EL}=15; **Baza 2019:** N_{TIK}=11, N_{SHMT}=13, N_M=13, N_{TH}=9, N_{EL}=9; **Baza 2020:** N_{TIK}=29, N_{SHMT}=30, N_M=18, N_{TH}=14, N_{EL}=12; **Baza 2021:** N_{TIK}=33, N_{SHMT}=29, N_M=34, N_{TH}=8, N_{EL}=17; **Baza 2022:** N_{TIK}=37, N_{SHMT}=18, N_M=16, N_{TH}=13, N_{EL}=17

Të ndara sipas gjinisë përzgjedhja e të njëjtës degë studimi jepet në figurën 30. Sikurse vihet re, ndonëse numri vajzave është i vogël ato do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Për vitin 2022 kemi një rënie me 5 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.


Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza M:** 2018 (N=58); 2019 (N=47); 2020 (N=98); 2021 (N=115); 2022 (N=95); **Baza F:** 2018 (N=3); 2019 (N=8); 2020 (N=5); 2021 (N=6); 2022 (N=6)

Edhe për përzgjedhjen e së njëjtës shkollë, vërehet se vajzat do e përzgjidhnin të njëjtën shkollë në masën 83% (2022) nga 100% (2019-2021).

Figura 31: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza M:** 2018 (N=58); 2019 (N=47); 2020 (N=98); 2021 (N=115); 2022 (N=95); **Baza F:** 2018 (N=3); 2019 (N=8); 2020 (N=5); 2021 (N=6); 2022 (N=6)

3.12 Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtejshëm (shiko tabelën 14), 45% e të diplomuarve në vitin 2022 kanë pohuar se kanë dëshirë të kenë filluar biznesin e tyre. Aspiratat për sipërmarrje në këtë vit kanë shënuar nivelin më të lartë ndër vite, ku mesatarja nga 2016-2021 ka qenë 22%.

Parë në një këndvështrim krahasues, në planet e tyre për të ardhmen, mesatarisht 27% e të diplomuarve shprehen se dëshirojnë të gjejnë një punë të lidhur ngushtë me fushën e tyre të studimit. Ndërkohë, 22% (mesatarja e 7 brezave) shprehen se do ndjekin studime të mëtejshme dhe 24% se duan të emigrojnë jashtë vendit. Ndërkohë, dëshira për migrim të brendshëm vijon të mbetet e ulët.

Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Të jem punësuar	44%	9%	13%	13%	23%	14%	21%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	6%	17%	31%	33%	41%	36%	26%
Të kem filluar biznesin tim	11%	19%	26%	20%	23%	32%	45%
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	17%	28%	33%	13%	34%	16%	13%
Të kem emigruar jashtë vendit	6%	28%	25%	35%	36%	19%	19%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	28%	0%	2%	0%	2%	1%	2%
Tjetër	28%	10%	15%	15%	1%	1%	1%

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. Baza: 2016 (N=18), Baza: 2017 (N=58), 2018 (N=61); 2019 (N=55); 2020 (N=103); 2021 (N=121); 2022 (N=101)

4 Përfundime

Në këtë raport paraqiten rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të Shkollës Industriale Pavarësia duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në vitin 2016.

Disa nga gjetjet kryesore të gjurmimit për të diplomuarit e 2022 janë përmbledhur më poshtë:

- 81% e të diplomuarve të 2022 u gjurmuan një vit pas diplomimit.
- Nga një total prej 101 të anketuarish, 64% e tyre ishin në marrëdhënie pune (punësim/vetëpunësim), 11% pa punë, 7% po ndiqnin kualifikime të mëtejshme dhe 16% ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë. Dy vitet e fundit shënojnë vlerat më të larta të punësimit në të shtatë brezat dhe ato më të ulëta të papunësisë.
- 100% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 94% e të diplomuarve në Mekanikë dhe 94% e të diplomuarve në Elektroteknikë janë të punësuar, duke shënuar drejtimet me numrit më të lartë të të punësuarve një vit pas diplomimit. Drejtimi TIK është është ai me numrin më të lartë të papunësisë me 19% dhe njëkohësisht me numrin më të lartë të atyre që ndjekin studime të mëtejshme, po 19%. SHMT është drejtimi i dytë me numrin më të lartë të të papunëve me 11%.
- 54% e të diplomuarve në 2022 pohojnë se puna që ata bëjnë lidhet me studimet e tyre. Përqindja e të diplomuarve që janë shprehur se i përdorin njohuritë në vendin e punës "shumë/jashtëzakonisht shumë" për vitin 2022 është 39%. Vërehet një rënie me 22 pikë përqindje në karhasim me vitin 2021.
- Shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 32% më pak se paga minimale-35,000 lekë, 32% në 35,001-50,000 lekë, 10% në 50,001-65,000 lekë, 10% në 65,001-80,000 lekë dhe 16% në më shumë se 80,001 lekë. Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve, sidomos në tre brezat e fundit.
- Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve vëmë re se 23% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 20% e të diplomuarve në SHMT, 19% e të diplomuar në Elektroteknike dhe 18% e të diplomuarve në TIK, paguhen më shumë se 80,001 lekë në muaj. Ndërkohë, në fashën e pagave 50,001-80,000 lekë, paguhen përkatësisht 25% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 8% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 40% e të diplomuarve në Mekanikë, 20% e të diplomuarve në SHMT dhe 9% e të diplomuarve në TIK.

- 70% e të diplomuarve janë punësuar para se të diplomohen, kjo shënon një rritje në raport me vitin 2021 ku vetëm 52% e të diplomuarve gjenin një punë para se të diplomoheshin. Ndërkohë, 10% janë punësuar një muaj pas diplomimit, 9% deri në tre muaj pas diplomimit dhe vetëm 4 % një vit pas diplomimit.
- Të diplomuarit përgjithësisht ndihen të sigurt dhe të kënaqur në punën e tyre aktuale, ku rreth 68% e tyre janë përgjigjur “të sigurt/shumë të sigurt” dhe 72% “të kënaqur ose shumë të kënaqur. Vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.
- Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit është 11%. Në vlera absolute kjo shifër shkon në 11 të papunë. Të pyetur nëse po kërkojnë për një mundësi punësimi, 8 prej tyre (73%) janë përgjigjur po.
- Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2022, mbi 40% e të gjurmuarve vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Përkatësisht, praktika në biznes (49%), bashkëpunimi me bizneset (49%), aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve (48%) dhe praktika në shkollë (48%), vlerësohen se kanë më shumë nevojë për përmirësim.
- Brenda dy viteve të ardhshme 26% e të diplomuarve në vitin 2022 planifikojnë të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit, 19% e rasteve të kenë emigruar jashtë vendit, dhe vetëm 2% të kenë migruar në një qytet tjetër.
- Aspiratat për sipërmarrje në 2022 ka shkuar në nivelin 45% duke shënuar nivelin më të lartë ndër vite.